



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.12.2020, ora 09:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Adnor Shameti – kryetar i Nënkomisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18 shkurt 2020.
2. Seancë dëgjimore me ministrin e Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, lidhur me veprimtarinë e:

Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2020;

Qendrës së Botimeve për Diasporën për vitin 2020;

Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitin 2020;

Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët për vitin 2020.

**Marrin pjesë:** Adnor Shameti, Eglantina Gjermani, Elona Hoxha, Halit Valteri, Ediola Braha.

#### **Mungojnë:**

#### **Të ftuar:**

Pandeli Majko – Ministër i Shtetit për Diasporën

Sonila Hysi – Drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare për Diasporën

Alma Kordoni – Drejtoreshë e Projekteve në Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Majlinda Vogli - Drejtoreshë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Mimoza Hysa – Drejtoreshë e Qendrës së Botimeve për Diasporën

Diana Kastrati – Drejtoreshë e Qendrës se Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshet

## HAPET MBLEDHJA

**Adnor Shameti** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Duke uruar që ju dhe familjarët tuaj të jeni mirë në këtë kohë të vështirë, vazhdojmë me mbledhjen e nënkomisionit për Diasporën, si pjesë e Komisionit për Politikën e Jashtme.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 18. 2. 2019. Si pikë të dytë kemi seancë dëgjimore me ministrin e Shtetit për Diasporën, zotin Pandeli Majko, lidhur me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2020; Qendrës së Botimeve për Diasporën për vitin 2020; Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për vitin 2020 dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët për vitin 2020.

Në mbledhjen e këtij nënkomisioni janë të ftuar zoti Pandeli Majko, ministër i Shtetit për Diasporën, zonja Sonila Hysi, Drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare për Diasporën, zonja Majlinda Vogli, Drejtoreshë e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, zonja Mimoza Hysa, Drejtoreshë e Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe zonja Diana Kastrati, Drejtoreshë e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Përpara se t'ia jap fjalën ministrit Majko dua t'ju sqaroj që mbledhja e këtij nënkomisioni dhe raportimi i ministrit për Diasporën, bashkë me drejtorët e agjencive përkatëse, që janë pjesë e strukturës organizative të kësaj ministrie, bëhet mbi bazën e nenit 102, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, ku komisionet dhe nënkomisionet parlamentare kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat për të dhënë shpjegime dhe sqarime të mëtejshme për probleme të fushave ku ata janë individualisht përgjegjës, si dhe për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, të rezolutave apo të deklaratave të miratuara nga Kuvendi. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve, japin shpjegime dhe informojnë periodikisht përmes seancave dëgjimore dhe botimeve të ndryshme për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre.

Sikurse jeni në dijeni, në vitet e shkuara i kemi bërë pas Vitit të Ri raportimet e këtyre agjencive, por duke qenë se jemi në vit elektorale dhe zgjedhjet do të zhvillohen prillin e vitit të ardhshëm, e çmuam të udhës që këtë seancë ta zhvillojmë para Vitit të Ri.

Duke ju falenderuar edhe një herë të gjithëve, fjalën e ka ministri i Shtetit për Diasporën, zoti Pandeli Majko, që të na informojë në lidhje me atë që parashtrova më sipër. Apo do të flasim në fillim drejtuesit e agjencive dhe në fund do të flisni ju, zoti Majko? Si mendoni të procedojmë?

**Pandeli Majko** – Unë do të përipiqem të zbatoj ato kërkesa që parashtruat ju, në mënyrë që të jemi sa më konciz.

**Adnor Shameti** – Duke ju kërkuar ndjesë për vonesën që u krijua për shkak të probleme të IT-së, unë do t’ju lutesha të jemi racionalë në raportime. Të gjithë anëtarët e nënkomisionet i kanë në *e-mail*-in zyrtar të gjitha materialet, kështu që do t’ju lutesha të flisni shkurtimisht në mënyrë që të jemi operativë dhe të mos bëhemi pengesë edhe për zhvillimin e mbledhjes së Komisionit të Ligjeve.

Faleminderit!

**Pandeli Majko** – Së pari, dua t’ju falenderoj për organizimin e mbledhjes së sotme! Ashtu siç u shpreh edhe kryetari i nënkomisionit të Diasporës dhe Migracionit, raportimet e të katërta agjencive ne i kemi dërguar me *e-mail*. Siç e dini, viti 2020 ka qenë mjaft i vështirë për arsye të emergjencës së COVID-it, por kjo nuk na ka penguar që për sektorin e politikave shtetërore për diasporën ne të miratojmë strategjinë e dytë. Ndoshta nga sektorët e veprimtarisë shtetërore është ndër të rrallët që brenda një periudhe trevjeçare, nga viti 2017, ka miratuar dy strategji. Strategjia e parë ka qenë 2018-2024, por për arsye të ecurisë së shpejtë, për të cilën ne ju kemi vënë në dijeni si anëtarë të nënkomisionit edhe nëpërmjet buletineve tremujore, strategjia “u vjetërsua” dhe nga data 1 janar do të fillojë një strategji e re 2021-2025, e miratuar në bashkëpunim edhe me strukturat ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe zyrën e IOM-it në Tiranë.

Katër agjenci, organizimi i një dhome biznesi dhe një gazetë është struktura që aktualisht mbulohet nga veprimtaria shtetërore e fushës sime të përgjegjësisë, por, gjithsesi, më në detaje do të flasim drejtueset e katër agjencive shtetërore. Mendoj që ka qenë një vit me goxha dhe për më tepër do të doja që fjalën ta kishin ato.

Faleminderit!

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti Majko!

Fjalën e ka zonja Hysi, drejtoreshë e Agjencisë Kombëtare për Diasporën, për të na bërë një përmbledhje të shkurtër 3-5 minuta.

**Sonila Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar i nënkomisionit,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni t’ju falenderoj për mbështetjen që ky nënkomision, por edhe Komisioni për Politikën e Jashtme, i ka ofruar Agjencisë Kombëtare të Diasporës, si një ndër institucionet kryesore shtetërore, përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën shqiptare. Kjo mbështetje është reflektuar në miratimin e ndryshimeve të rëndësishme në legjislacion gjatë vitit 2020, por edhe në miratimin e buxhetit që do t’i alokohet kësaj agjencie për vitin 2021.

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka reflektuar në punën e saj gjatë vitit 2020 misionin e saj për nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me komunitetin shqiptar në diasporë, duke synuar zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në zhvillimin ekonomik, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë.

Ne ju kemi dërguar paraprakisht në rrugë elektronike pranë sekretarisë së nënkomisionit një kopje të raportit vjetor të vitit 2020, ku pasqyrohet në mënyrë të detajuar një përmbledhje e funksioneve dhe aktiviteteve të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe të gjitha aktivitetet financiare të agjencisë.

Ndër arritjet e vitit 2020, për Agjencinë Kombëtare të Diasporës, ashtu siç edhe ministri e përmendi, janë miratimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të Planit të Veprimit 2021-2025, hartimi i paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Shqipërisë, si dhe ofrimi i bursave për studentët e huaj me origjinë shqiptare. Agjencia Kombëtare e Diasporës, në zbatim të detyrave funksionale të saj, ndjek zbatimin e strategjisë kombëtare të diasporës dhe planin e saj të veprimit. Nga janari 2021 hyn në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e strategjisë kombëtare të diasporës 2021 -2025 dhe të planit të veprimit. Kjo është strategjia e dytë që qeveria shqiptare ka miratuar për marrëdhënien me diasporën. Dy vite më parë, u miratua strategjia kombëtare e diasporës 2018-2024, e cila ishte i pari dokument në llojin e vet. Zhvillimet dinamike sollën nevojën për rishikimin dhe përmirësimin e këtij dokumenti të rëndësishëm, për marrëdhënien e shtetit shqiptar me diasporën.

Gjatë viti 2020 Agjencia Kombëtare e Diasporës ka koordinuar veprimtarinë administrative ndërmjet institucioneve përgjegjëse, për zbatimin e strategjisë, si dhe ka bashkëpunuar me to për realizim në afat të mesëm të masave të planit të veprimit. Me qëllimin e zbatimit të parimit të transparencës dhe të së drejtës së informimit, gjithashtu, Agjencia ka publikuar çdo 3 muaj buletin për realizimin e planit të veprimit të strategjisë. Këto buletine janë depozituar edhe pranë Komisionit për Politikën e Jashtme dhe nënkomisionin Për diasporën dhe Migracionin.

Në vitin 2020, në kuadër të ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kombëtare, si dhe forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, Agjencisë Kombëtare e Diasporës, për vitin akademik 2020-2021 do të financojë 9 bursa për studentët e huaj me origjinë shqiptare, si dhe do të kryejë pagesat e mësuesve të nevojshëm për mësimin e gjuhës shqipe në vitin e parë akademik, për studentët e huaj me origjinë shqiptare. Në kushtet kur, siç parashikon ligji për

krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ky institucion mund të ftojë edhe subjekte të tjera vendase ose të huaja për bashkëfinancim projektsh, të cilat do të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe forcimin e lidhjes ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës.

Agjencia, në vitin 2020 ka përfituar një marrëveshje financiare nga Bashkimi Europian, marrëveshja financiare përkon me periudhën 2020-2021 me projektin që do të asistojë Agjencinë Kombëtare e Diasporës në zhvillimin e kapaciteteve dhe të ekspertizës për menaxhimin e politika dhe aktiviteteve të dedikuara për diasporën sipas praktikave bashkëkohore të Bashkimit Europian. Aktivitetet kryesore të projektit lidhen me organizimin e aktiviteteve trajnuese, trajnime, workshop, seminare për stafin e Agjencisë dhe institucionet qendrore të përfshira në zbatimin e strategjisë për diasporën dhe të planit të veprimit. Ky financim është përfitimi i projektit IPA 2020.

Gjithashtu, Agjencia Kombëtare për Diasporën është pjesë e programit “Migrimi dhe Diaspora financuar nga qeveria Gjermane, nëpërmjet pjesëmarrjes me trajnime të stafit të Agjencisë, me qëllim përcjelljen e *know how* në strukturën e ngritur administrative për diasporën dhe migracionin në një njësitë e qeverisjes vendore.

Sa i takon llogari-dhënies mbi shpenzimet buxhetore, Agjencia, për realizimin e buxhetit të shtetit për vitin 2020, është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrave që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, duke mbajtur në vëmendje që në kushtet e pandemisë COVID Agjencia rialokoi aktivitetet e miratuara nga këshilli drejtues në aktivitete të tjera të realizuara në kushtet e një pandemie globale.

Në vitin 2020, Agjencisë iu akordua një fond buxhetor prej 81,500 milionë lekësh. Ky fond është i ndarë në 3 zëra, shpenzime personeli, shpenzime korrente, shpenzime kapitale. Sipas aktit normativ për buxhetin e vitit 2020, të ndryshuar, Agjencisë Kombëtare të Diasporës iu pakësuan fondet buxhetore me vlerën 6 milionë lekë. Për sa më sipër, referuar këtij buxheti, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka zbatuar politikat e veta ekonomike për një menaxhim sa më të mirë dhe me një efektivitet të shpenzimeve buxhetore duke planifikuar shpenzimet e kontraktuar si dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme, siç janë realizimi i shpenzimeve të detyrueshme...

**Adnor Shameti** – Zonja Hysi, shumë faleminderit!

Mendoj që mjaftohemi me këtë pjesë të raportimit, sepse pjesa e shifrave është e pasqyruar në relacion. Dua t’i jap fjalën zonjës Vogli.

Të nderuar kolegë, ju lutem që, pasi të mbarojë raportimi nga të gjitha drejtoreshat përkatëse, jeni të lutur të bëni pyetje apo diskutime në lidhje me këto raportime.

**Sonila Hysi** - Faleminderit!

**Alma Kordoni** – Përshëndetje të gjithëve!

Para se të filloj, si përfaqësuese e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, dua të bëj një sqarim, zonja Vogli e ka të pamundur të jetë prezente, për arsye shëndetësore dhe për këtë arsye jam unë për të bërë prezantimin e Fondit.

**Adnor Shameti** - Ju lutem, emrin tuaj.

**Alma Kordoni** – Alma Kordoni, drejtoresha e projekteve.

**Adnor Shameti** - Faleminderit!

**Alma Kordoni** – Faleminderit juve!

**Adnor Shameti** – 3 deri në 5 minuta, ju lutem për kohë.

**Alma Kordoni** - Po, i nderuar kryetar. Të nderuar anëtarë të komisionit, më lejoni të bëj një prezantim të shkurtër të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, mbi veprimtarinë. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës ka paraqitur në raportin e tij vjetor të vitit 2020 veprimtarinë e tij gjatë këtij viti, projektet e zbatuara, arritjet, burimet financiare, burimet njerëzore, analizën financiare për këtë vit, si dhe sfidat e ndeshura dhe mësimet e nxjerra. Gjithashtu, pjesë e raportit është edhe planifikimi i vitit 2021.

Raporti ka një fokus të veçantë lidhur me projektet e zbatuara, projektin “Diaspora për zhvillim”, projektin “Diaspora shkencore si pasojë ndryshimi në procesin e integritit europian të Shqipërisë”, projektin “Dhoma e biznesit të diasporës, krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipërisë”, si dhe projekti gazeta “Diaspora shqiptare”, i financuar nga qeveria e Konfederatës së Zvicrës. Më lejoni të ndaj me ju disa nga rezultatet apo produktet e këtyre katër projekteve, të cilat në këtë periudhë, gjatë vitit 2020, si vit i vështirë i është përshtatur shumë situatës, duke e parë një mundësi të madhe për t’i qenë më pranë diasporës nëpërmjet platformave elektronike.

Është krijuar Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës, ku përdoruesve profesionistë dhe shqiptarë u janë ofruar mundësi formimi, bashkëpunimi nëpërmjet një *website*-i të dedikuar. Ky *website* ose portal është në formën e një *LinkedIn*-i shqiptar, i cili u jep mundësi të gjithë profesionistëve të aksesojnë informacion, si dhe të kenë mundësi të regjistrohen në të dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

Gjithashtu, është edhe platforma “Si të fillosh një biznes në Shqipëri”, e cila i është dedikuar projektit të Dhomës së Biznesit për diasporën shqiptare, që e përmendi pak më parë edhe zoti ministër Majko. Kjo platformë është krijuar për të shërbyer si një platformë informuese për investitorët e mundshëm, si dhe jep një informacion për klimën e biznesit dhe investimet në Shqipëri. Kjo platformë, gjithashtu, aksesohet nëpërmjet rrugës elektronike.

Gjithashtu, platforma “Dixhitalizimi i veprave shqiptare” është krijuar për të gjallëruar promovimin e kujtesës kolektive kulturore, si dhe u jep mundësi shqiptarëve të diasporës të lexojnë letërsi shqipe. Është e aksesueshme falas. Rreth 230 vepra janë në portal të dedikuar dhe janë të aksesueshme për shqiptarët e diasporës.

Kemi publikimin e periodikut dhe punimeve shkencore, që ka filluar që prej vitit 2019 dhe botohet çdo gjashtë muaj. Prodhohen dy periodikë dhe është e mundshme që të gjitha studimet, artikujt shkencorë të përmbliidhen në një dokument të dedikuar “Diaspora shqiptare”.

Gjithashtu, është krijuar një media online gjatë këtij viti, e cila është gazeta “Diaspora shqiptare”, ku i jepet mundësia të gjithë komunitetit të diasporës të marrë dhe të shkëmbejë informacion. Ky portal u jep mundësi apo është një hapësirë për të shprehur opinionin e konsoliduar të diasporës shqiptare *online*. Këto janë disa nga fotot.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020 ka pasur sfida të ndryshme që lidhen përgjithësisht me situatën e COVID-it. Pandemia afektoi modifikimin e metodologjisë së zbatimit të aktiviteteve; iu përshtatën situatës. Pati vështirësi për të pasur kontakte të drejtpërdrejta me diasporën; u përshtat me mundësi për të komunikuar me to në distancë dhe *online*. Masat e marra në Europë dhe në botë për udhëtime jashtë Shqipërisë afektuan mosorganizimin e udhëtimeve dhe takimeve me diasporën, si dhe thirrjet e mundësitë për projektpropozime të reja qenë të kushtëzuara apo të limituara nga situata e pandemisë.

Planifikimi 2021: synohet dhe është planifikuar përshkallëzimi progresiv i veprimtarisë së Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.

Faleminderit!

**Adnor Shameti** – Faleminderit për raportimin e pjesës së 2020-ës.

Për 2021-shin kemi kohë, se do të kemi vitin tjetër në vijim.

Fjalën e ka zonja Hysa, si Drejtoreshë e Qendrës së Botimeve.

**Mimoza Hysa** – Përshëndetje!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Nënkomisionit,

Po bëj një paraqitje të shkurtër lidhur me punën e Qendrës së Botimeve për Diasporën në këtë vit të vështirë pandemie.

Do të thosha që viti 2020 ka qenë vit i parë për të krijuar fizionominë e qendrës... (*Nuk dëgjohet.*)

Nisur nga misioni parësor që ka qendra, që është ruajtja, mbështetja dhe promovimi i mësimit të gjuhës shqipe në diasporë, në vitin 2020 qendra arriti të sigurojë, të botojë dhe të shpërndajë rreth 18 mijë tekste dhe materiale plotësuese në 22 vende të botës. Thënë kështu,

duket si një detyrë e përmbyllur si detyrë postare. (*Nuk dëgjohet.*)...e gjithë puna përgatitore në hartimin e bazës së të dhënave të shkollave, të kurseve të mësimit të gjuhës shqipe dhe të mësuesve në diasporë. Qendra ka arritur tashmë të ketë një impakt të plotë për 450 mësues të shpërndarë në diasporë dhe të mbi 250 shkollave. Dërgesën këtë vit e arriti përmes një sfide me veten, meqenëse, siç e dimë, ishte vit i vështirë për lëvizshmërinë në të gjithë botën. Megjithatë, u arrit që tekstet të dërgoheshin brenda muajit gusht. Pra, Qendra e Botimeve e përmbylli brenda muajit gusht, ndërkohë që u shpërndanë në të gjithë botën brenda shtatorit. Për herë të parë qendra arriti që të ketë botimet e saj, me logon e saj, dhe të zbatojë programin e botimeve dygjuhësore. Do të ndalesha pak te këto botime, pasi përbëjnë edhe thelbin e strategjisë së punës të qendrës, meqenëse kjo e fundit e kishte planifikuar qysh vitin e kaluar hartimin e këtij projekti, i cili ndahej në botimin e nëntë fjalorëve me ilustrime për fëmijë në nëntë gjuhë të vendeve, ku ka më shumë prezencë të shqiptarëve dhe kështu botimin e një serie përrallash klasike të 7 librave me dy rrëfenja secila. Pra, 14 përralla në tri gjuhë, 21 tekste dygjuhësore me 42 përralla të përkthyer.

Ndoshta shifrat lënë të kuptojnë që një qendër botimi, që ka pasur vitin e parë buxhetor të saj, ka arritur që tashmë në portalin e Qendrës së Botimeve t'i ketë të shkarkueshme pikërisht këto 21 tekste dhe nëntë fjalorë, mbi 30 botime brenda vitit. Katër prej fjalorëve dhe tre seri të përrallave janë të shtypura në *hard-copy* dhe të dërguara në shkollat shqipe në diasporë.

Gjithashtu, ky program përfshin edhe përkthimin, përgatitjen për botim të “Tregimeve të moçme shqiptare” të Kutelit në pesë gjuhë. Dihet se kjo është një vepër monumentale për letërsinë shqipe dhe themi me krenari që Qendra e Botimeve ka arritur tashmë të ketë gati përkthimin dhe redaktimin, ndërkohë që në janar të vitit të ardhshëm nis edhe botimi i veprës së Kutelit për t'u shpërndarë pastaj në diasporë.

Gjithashtu, në programin e përkthimeve është përfshirë edhe revista e parë letrare dygjuhësore “Letra nga diaspora”, ku janë angazhuar shkrimtarët dhe përkthyesit më të mirë që jetojnë jashtë vendit.

**Adnor Shameti** – Shumë faleminderit, zonja Hysa!

Këto detaje i kemi të gjitha të pasqyruara atje, na mjaftonte vetëm pjesa e përmbledhjes.

Fjalën e ka zonja Kastrati, si Drejtoreshë e Qendrës së Studimeve për Arbëreshët.

**Diana Kastrati** – Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët është institucioni kërkimor shkencor për diasporën shqiptare. Krijimi i këtij institucioni u miratua me VKM nr.601, datë 04.09.2019.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është krijuar në kuadër të strukturës shtetërore për diasporën shqiptare. Ajo është institucioni i parë në historinë e shtetit



shqiptar që ka fokus ekskluziv studimet e specializuara që ngërthejnë gjithë universin kulturor, historik, letrar, social dhe antropologjik të komunitetit arbëresh, si një trashëgimi unike kulturore në mbarë botën. QSPA-ja synon mbrojtjen e kësaj trashëgimie përmes koordinimit të lidhjeve më të forta me këtë komunitet, për të ruajtur nga asimilimi gjuhën dhe kulturën e arbëreshëve dhe për të promovuar arritjet kryesore të saj.

Misioni i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është kryerja e studimeve të specializuara për historinë, gjuhën, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit mes studiuesve vendas dhe atyre në diasporë e më gjerë, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e strukturës së studimeve mbi komunitetin arbëresh.

Pjesë e misionit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët është vlerësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me komunitetet arbëreshe në botë, përmes organizimit të aktiviteteve dhe konferencave shkencore. Ato do të kenë në fokus cilësimin e historisë së komunitetit arbëresh si pjesë e shkencës albanologjike, por edhe rivlerësimin e marrëdhënieve të vendlindjes me komunitetin shqiptar më të vjetër në diasporë.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët synon që studimet dhe publikimet mbi Arbëreshët, të cilat do të kryhen prej Drejtorisë së Studimeve dhe të Publikimeve të kësaj qendre, të jenë të koordinuara me ato të institucioneve të tjera shkencore, si edhe me studiues të fushës, brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë vitit 2020 Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët ka synuar të jetë aktive me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke e formalizuar këtë me memorandumet, marrëveshjet dhe protokollet e bashkëpunimit si më poshtë:

Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët; Memorandumi i Bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë; Memorandumi i bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; Memorandumi i bashkëpunimit midis Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët; Marrëveshja e bashkëpunimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”; Marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë në mjediset e Institutit të Historisë; Marrëveshja e bashkëpunimit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” në vijim të bashkëpunimit ndërakademik; Marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Institutit Arkeologjisë së Kosovës; Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet

Qendrës Ndërkombëtare Ndëruniversitare CISVA dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zonja Kastrati për raportimitin, aq më tepër që jeni agjencia më e re e strukturës së Ministrisë të Shtetit për Diasporën!

Ju falenderoj të gjithëve për raportimet!

Para se t'ua jap fjalën kolegëve për diskutime, në cilësinë e kryetarit të nënkomisionit, kam dy pyetje për zotin Majko, bazuar në raportimin që u bë sot.

Së pari, meqenëse janë gjëra me ndjeshmëri të lartë për publikun shqiptar, do të doja t'ju pyesja se në çfarë pike apo në çfarë faze, pra çfarë ecurie ka pasur bashkëpunimi me autoritetet e huaja për marrëveshje bi apo multilaterale në fushën sigurimeve, pra për njohjen e viteve të pensionit për shtetasit shqiptarë që janë me banim jashtë shtetit?

Së dyti, sërish ka një rëndësi të madhe për opinionin publik. Ka qenë në strategjinë e veprimtarisë së qeverisë sonë bërja e mundur e votimit të emigrantëve shqiptarë, mundësisht që në zgjedhjet politike të radhës. A mund të na informoni, zoti Majko, në lidhje me hapat që janë ndjekur nga qeveria dhe nga ju personalisht në lidhje me këtë proces, pasi dua të sqaroj për të gjithë opinionin publik që është një proces, i cili ka qenë i lidhur me ndryshimet që bashkërisht miratuar në Kodin Zgjedhor (ishte një arritje shumë e madhe) dhe besoj se gjithë opinionin publik është i interesuar të dijë se si ka qenë deri tani dhe si do të jetë ecuria deri në votimet e 25 prillit?

Mendoj të përfundoni përgjigjet për këto pyetje dhe pastaj do ta kenë të gjithë kolegët për të bërë pyetje apo diskutime në lidhje me raportimet.

Faleminderit!

**Pandeli Majko** – Lidhur me çështjen e marrëveshjeve ndërshtetërore për pensionet apo për sigurimet shoqërore me shtetet pritëse të komuniteteve shqiptare apo, më specifikisht, të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, ne ju kemi dërguar një raportim të veçantë, i cili fillon me përditësimin e fundit të kordinatorit shtetëror të emëruar me udhër të veçantë të Kryeministrit për ndjekjen e çështjes së marrëveshjeve për pensionet. Ky është një moment, i cili bashkëlidhet pastaj me informacionin e veçantë vjetor që ju kemi nisur së bashku me të gjitha marrëveshjet, të cilat janë realizuar gjatë gjithë periudhës.

Është mjaft delikate të thuhet që në periudhën e mungesës së komunikimit dhe të vizitave të ndërsjella për të kryer negociatat përkatëse në periudhën e emergjencës së Covid-it, ashtu siç edhe në raportimin e kordinatorit shtetëror në nivelin e zëvendësministrit të jashtëm ka shkruar në raportimin e vet për vitin 2020, ka pasur vështirësi të kësaj natyre. Megjithatë, siç edhe shkruhet aty, një pjesë e negociatave në vazhdim do të bëhet edhe online.

Ecuria më e veçantë është marrëdhënie me një nga shtetet që ka komunitetin më të madh të shtetasve shqiptarë, me Italinë, pasi nga përfaqësuesit, edhe nga komunikimet, që kemi pasur *online*, edhe vetë, me përgjegjësit shtetërorë të qeverisë italiane, na është thënë se është zgjidhur çështja e buxhetit. Ka qenë momenti më delikat i diskutimeve me shtetin fqinj dhe tani, çështja e marrëveshjes së pensioneve, sipas meje, është vetëm një numër i mbrapshtë dhe një negociatë. Pala jonë është shprehur e gatshme të fillojë negociatat, duke nisur nga e nesërmja.

Për sa i përket pyetjes së dytë, për votimin e shtetasve jashtë vendit, dua t'ju them se jemi në komunikim të rregullt me kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas miratimit të Kodit Zgjedhor, veprimi im për të influencuar në këtë çështje është i rezervuar, sepse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një gjykatë thuajse në nivelin e gjykatës autonome për sa i përket vendimmarrjeve për votimin e shtetasve jashtë vendit, pasi me dy nenet që ka miratuar Kuvendi i Shqipërisë, i ka dhënë të drejtën nga a-ja te zh-ja të marrë vendime për këtë çështje.

Nuk e kemi lënë komunikimin vetëm me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por kemi filluar bashkëpunimin me OSBE-në 1 muaj pasi është miratuar ndryshimi i Kodit Zgjedhor...  
(*Nuk dëgjohet*)...

**Adnor Shameti** – Ka një shkëputje të linjës me zotin Majko.

Ju lutem, të presim një moment!

Po, zoti Majko.

Hapni mikrofonin, ju lutem!

**Pandeli Majko** – Erdhi teknika e Kryeministrit dhe u bënë disa ndërhyrje, sepse jemi në rikonstruksion për arsye të tërmeteve të vitit të kaluar.

Më lejoni të ripërsëris çështjen e të drejtës së votës dhe votimit të shtetasve të shtetasve jashtë vendit.

Siç e thashë, jemi në komunikim të përjavshëm me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Po ashtu, me OSBE-në, që në muajin gusht kemi filluar një komunikim dhe ata na janë përgjigjur për sa i përket angazhimit të një eksperti të huaj. Bashkë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jemi duke ndjekur situatën, por dëshiroj të theksoj se unë, si ministër Shteti, edhe si përfaqësues i qeverisë, jam i rezervuar për të bërë një ndërhyrje më tepër, pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kodin Zgjedhor është me të drejta të gjykatës autonome për u përket vendimmarrjeve për të drejtën e votës së shtetasve jashtë vendit. Deri tani i jemi përgjigjur çdo kërkesë që ka ardhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Gjithashtu, kemi organizuar edhe koordinimin e interesave të grupeve të interesit nga komunitetet shqiptare jashtë vendit, sidomos të Këshillit të Koordinimit të Diasporës, i cili ka pasur biseda të veçanta dëgjimore me kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ecurinë e kësaj çështjeje.

Jemi në pritje që vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të jetë sa më shpejt e mundshme dhe pozitive për të drejtën e votës së shtetasve jashtë vendit. Kjo është garantuar tashmë në bazë të ligjit dhe bëhet fjalë vetëm për aspekte teknike.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti Majko!

Kolegë të nderuar, keni pyetje për raportimet që u bënë sot në nënkomision?

Po, zonja Gjebrea.

**Elona Gjebrea** – Faleminderit, zoti kryetar i nënkomisionit!

I nderuar, zoti Ministër,

Përfaqësues dhe drejtues të agjencive të rëndësishme brenda Ministrisë së Shtetit për Diasporën,

Të nderuar kolegë,

Ju falënderoj për raportimin e detajuar dhe, nga ana tjetër, edhe për raportimin në mënyrë të vazhdueshme të të gjitha dokumenteve që ju keni prodhuar!

Në fakt, është model mënyra e bashkëpunimit me përfaqësuesit e Kuvendit. Ne jemi të azhurnuar për të gjitha publikimet apo raportimet që ka pasur Ministria e Shtetit për Diasporën.

Sigurisht, me aq sa dëgjova, dhe me sa kam lexuar, pa dyshim që ka arritje, janë vendosur në vijë shumë gjëra që ishin të nevojshme dhe jam e bindur që kërkonti të bëni më shumë.

Zoti Majko, do të isha kurioze nëse do të na përmendit 2-3 arritjet kryesore që ju mendoni se keni bërë vitin e kaluar dhe çfarë keni sfidë për aq sa kanë ngelur për këtë ministri të rëndësishme?

Pyetjen për sa i përket regjistrimit të emigrantëve ma dogji kolegu Shameti, ndaj do të isha kurioze thjesht për këtë, pasi ka shumë detaje dhe unë e mora informacionin.

Faleminderit!

**Adnor Shameti**– Faleminderit, zonja Gjebrea!

Ka pyetje tjetër nga kolegët?

Po, zonja Gjermani.

**Eglantina Gjermani** – Përshëndetje!

Zoti Ministër, ju falënderoj për prezantimin dhe raportimin periodik dhe shumë të hollësishëm!

Gjithashtu, edhe zonjave drejtuese të institucioneve të kësaj ministrie!

Me sa duket, ministri Majko e ka vlerësuar shumë barazinë gjinore dhe mua më vjen mirë t'i shikoj të gjitha zonjat drejtuese, dhe me një përkushtim dhe angazhim ...

**Adnor Shameti** – E ka tejkaluar, doje të thoshe?

**Eglantina Gjermeni** – Jo, nuk do të thosha se e ka tejkaluar, por ndihet kënaqësia dhe lezeti, sepse puna dhe përkushtimi flasin vetë. Komplimente!

Doja të pyesja: gjatë këtij viti pandemie, edhe me shkurtimet e buxhetit, edhe me këto vështirësi që po kalojmë të gjithë, a pati aktivitete që nuk u realizuan nga Ministri për Diasporën apo nga institucionet përgjegjëse, gjë që mbase ndikoi në punën tuaj dhe, si të thuash, nuk arritët të përmbushnit objektivat?

Pyetja tjetër lidhet me platformat. Këtu u diskutuan platformat, që unë në fakt i vlerësoj shumë, qoftë ajo për biznesin, qoftë për pjesëmarrjen dhe regjistrimin e një data baze të të gjithë diasporës. Mendoj se kemi qenë të vonuar, ndaj shyqyr që u bë, dhe besoj se do të ketë një impakt shumë pozitiv.

Vetëm në periudhën e këtij viti, në *lockdown* -e pamë mjekë, specialistë, ekspertë shqiptarë në të gjithë botën, të cilët na bënë shumë krenarë. Është shumë i nevojshëm edhe kontributi e angazhimi i tyre në sfidat që kemi. Unë e shoh rolin tuaj shumë të rëndësishëm për të përcjellë këndvështrimet, por edhe ekspertizën e tyre në Shqipëri.

Kësisoj, do të doja të dija një çikë më shumë në lidhje me platformat që ju përmendët, si dhe në lidhje me impaktin: si kanë ecur? Jo si i keni bërë ju, por çfarë po ndodh me to? A janë regjistruar përfaqësuesit e diasporës? A po kontribuojnë? Ose edhe në lidhje me biznesin: a ka diçka me të cilën mund të krenohemi?

Faleminderit!

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zonja Gjermeni!

Zoti Majko, fjala për ju!

**Pandeli Majko** – Së pari, ju kërktoj ndjesë në lidhje me problemet e komunikimit, por siç ju thashë, jemi në situatë rikonstruksioni.

Dua t'i rikthehem procesit të regjistrimit të migracionit. Besoj se kjo po ndodh në dy drejtime. Së pari, kemi një proces, që është me fat do të thosha, që nuk i kushton asnjë shpenzim shtetit shqiptar: procesi i ribërjes së pasaportave pasi është mbushur afati i përdorimit të pasaportave.

Ne kemi insistuar pranë strukturave përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme, që të vihet një angazhim i veçantë dhe t'u jepet informacion të gjithë shtetasve tanë jashtë vendit, të cilët

edhe kështu janë goxha të interesuar, që të vendoset adresa e duhur kur bëhet regjistrimi i pasaportave të reja.

Ngatërrohet regjistrimi i adresave dhe i shtetasve të vendit me listën e votuesve jashtë vendit, ndaj ndonjëherë krijohet ideja se po s'u bë regjistrimi i adresave, nuk mund të ketë aplikim të së drejtës së votës. Nuk është e vërtetë. Sistemi që do të krijohet pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas modelit, po themi, të një shteti më të ri të rajonit, Kosovës, është me aplikim nga shtetasit tanë jashtë vendit, të cilët aplikojnë me pasaportë ose me kartë identiteti, dhe kjo krijon listën e votuesve, jo e kundërta: nga lista e adresarit të krijohet të krijohet lista e votuesve. Në Shqipëri do të përdoret sistemi vullnetar, ose më saktë, siç jemi ne familjarë, sistemi amerikan, që do të regjistrohen adresat.

Cila është sfida, sfida e ardhshme, për 2021-shin apo sfida e gjithë strukturës shtetërore që aktualisht merret me diasporën?

Kolegë, ju kujtoj se, kur jam paraqitur për herë të parë përballë jush, e që kam pasur përkrahjen maksimale, sidomos në nënkomision dhe në Komisionin e Politikës së Jashtme, e kemi filluar me katër vetë. ishte vetëm kabineti im. Sot keni përballë katër drejtoresha agjencish, që mbulojnë profile të ndryshme të fushave shtetërore të përgjegjësisë për diasporën shqiptare.

Sfida është futja e veprimit të këtyre agjencive në rutinën e normalitetit administrativ, pasi agjencia e fundit e krijuar, është Qendra e Arbëreshëve, e cila ka një jetë administrative diçka më shumë se gjashtë muaj. Megjithatë, po të shikoni në të gjitha raportet vjetore, aktualisht të gjitha agjencitë e kanë krijuar profilin e tyre jo vetëm administrativ, por edhe për sa i përket punës që ato do të duhet të bëjnë në distancë me një komunitet shtetasish dhe bashkatdhetarësh, të cilët nuk ndodhen në Shqipëri.

Po kthehem te përgjigja për pyetjen e zonjës Eglantina, sa i përket rrjetit të bizneseve.

Aktualisht, krijimi i dhomës së biznesit mund të konsiderohet si një nga sukseset më të mira, së bashku me rrjetin e profesionistëve. Janë dy platforma që komunikojnë me njëra-tjetrën. Pra, nuk po merremi thjesht me komunikimin me organizatat aktuale që ekzistojnë në diasporë, por po organizojmë rrjetet e profesionistëve. Kjo sepse shpeshherë, më të suksesshmit në diasporë nuk janë të përfshirë në organizatat e ndryshme të komuniteteve shqiptare. Madje, që ta themi troç: më të suksesshmit janë pak më të lidhur me interesat e punës, me angazhimin e tyre profesional, ndaj nuk angazhohen kollaj.

Sa i takon rrjetit të profesionistëve, kemi gjetur një mekanizëm, i cili nuk është shpikja jonë, që është mbështetur në eksperiencat më të mira. Aktualisht, është një nga eksperimentet, po e quaj kështu, i cili përsëri bazohet në një model ndërkombëtar: duke nisur nga 1 janari, do

të fillojë aplikimi i një projekti tjetër, i cili quhet Connect Albania. Do të ftohen të gjitha resurset që ne kemi në diasporë, për të ndërmjetësuar për investimet e huaja në Shqipëri. Pra, do të krijohet një strukturë, e cila quhet Connect Albania, pranë Dhomës së Biznesit. Ky është një projekt me donatorë italianë dhe me Zyrën e IOM-it në Shqipëri, ku do të krijohet një status ndërmjetësimi për investimet në Shqipëri nga përfaqësuesit e diasporës, të cilët do të shpërblehen për çdo fuqi punëtore të angazhuar në këto investime, kur investimi të jetë i suksesshëm.

Pra, nga një moment patriotik, do ta bëjmë edhe moment të një përfitimi financiar. Nëse nuk do të kishim situatën e emergjencës së Covidit, sot ne do t'ju kishim “bombarduar” me aktivitete natyrale vjetore, siç është takimi i bizneseve.

E nisëm këtë vit, ende pa filluar Covidin, duke organizuar samitin e Grave të Biznesit, që është një strukturë goxha vibrante, do të vazhdonim me takimin e mësuesve. Sapo krijuam Këshillin Koordinativ të Arsimitarëve në diasporë. Siç e tha drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ka filluar dhënia e bursave për herë të parë.

Tani në dhjetor bëhet fillimi i krijimit, pra do të bëhet prokurimi i fondeve të agjencisë për bazën e të dhënave për studentët. Ministria e Drejtësisë ka filluar regjistrimin apo krijimin e regjistrit, sepse s’do të merremi vetëm me më të suksesshmit, por edhe me ata që janë në pozita të vështira, që janë në kushtet e humbjes së lirisë.

Pra, është një profil pune administrative shumëplanëshe. Nuk them se jemi duke i bërë qejfin vetes, por në disa raste jemi të detyruar të koordinojmë rreth 70% të administratës shqiptare për të bërë realizimin e 72 masave të strategjisë kombëtare. Është një punë goxha e detajuar, e cila kërkon bashkëveprim me shumë institucione të tjera. Kjo është arsyeja që ne ju bashkëngjitem edhe raportimin vjetor të koordinatorëve shtetërorë, që janë zëvendësministra nga institucione të ndryshme, por që i lidh puna, koordinimi i punës që u ngarkon urdhri i veçantë i Kryeministrit me profilin e punës së agjencive shtetërore.

Ju siguroj se të gjitha agjencitë janë të angazhuara maksimalisht që në vitin 2021, pavarësisht se është vit elektorale, të orientohen nga rutina e tyre administrative të paprekura nga historitë e natyrave elektorale, pasi ka një përshtatje të profilit administrativ edhe për sa i përket emergjencës ndaj COVID-it.

**Adnor Shameti** – Shumë faleminderit, zoti Majko!

Zonja Gjebrea ka një koment të fundit.

**Elona Gjebrea** – Faleminderit!

Ndoshta nuk e mora përgjigjen ashtu siç duhet, por e mirëkuptoj kohën në dispozicion. Kam vetëm një pyetje për zotin Majko në lidhje me atë çfarë tha për sa u përket emigrantëve,

pra se është e pavarur puna që do të bëhet për votimin e tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili ka autoritetin më të lartë me regjistrimin e tyre. Si qëndron kjo në lidhje me ligjin më të fundit, mbaj mend të vitit 2016, ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Jashtme në momentin kur emigrantët do të kërkojnë shërbime, kushti kryesor është që ata të kenë të regjistruar adresën dhe kjo është një gjë e miratuar nga qeveria? Jam pak konfuzë për këtë gjë.

**Pandeli Majko** – Ligji “Për adresat” është miratuar nga parlamenti i Shqipërisë përpara se të miratoheshin ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Ligji “Për adresat” është kur kemi të bëjmë me një situatë të ndërmjetme, që një shtetas, i cili banon në Milano, vendos të shkojë në Palermo apo të lëvizë nga Italia në Gjermani, është i detyruar të raportojë. Ky është një detyrim standard i të gjithë shtetasve të çdo shteti që, kur jetojnë jashtë vendit, duhet të raportojnë adresat e tyre. Por kjo nuk ka të bëjë me të drejtën e votës. Ky është një moment regjistrimi burokratik, kur ti ndryshon adresën, pra shkon nga një rrugë në një tjetër, nga një qytet në një tjetër, nga një shtet në një tjetër. Kjo për arsyen e thjeshtë, sepse, kur keni bërë regjistrimin e pasaportës suaj apo kur keni bërë aplikimin për pasaportë, ju keni vendosur atje një adresë: Itali, Milano, rruga X, pallati Y, siç janë adresat. Shteti shqiptar në gjendjen civile ka të regjistruar të gjithë shtetasit, të cilët kanë vendosur adresën e tyre jashtë vendit. Ka pasur lapsuse të natyrave të ndryshme, kur nuk kanë vendosur adresën e tyre jashtë vendit, por kanë vendosur adresën e shtëpisë së vjetër në Shqipëri. Ky është lapsus, nuk është rregull. Po e përsëris, nuk ka të bëjë regjistrimi i adresës me të drejtën e votës. E drejta e votës do të bëhet duke marrë pasaportën apo kartën e identitetit, sipas rregullave që do të vendosë KQZ-ja dhe në të aplikohet. Po të shikoni në ligjin përkatës, babai apo kryefamiljari mund të regjistrojë me kartën e tij të identitetit të gjithë familjen. Kjo nuk mund të funksionojë për regjistrimin e shtetasve për të drejtën e votës, sepse secili duhet të regjistrohet me kartën e tij personale të identitetit. E dhashë këtë shembull për të thënë, keni shumë të drejtë, zonja Gjebrea, që është krijuar një lloj kakofonie, duket sikur, nëse ti nuk regjistron adresën apo ndryshimin e saj, nuk ke të drejtë të votosh. Pranë KQZ-së, sipas të gjitha eksperiencave që ekzistojnë, do të krijohet një sistem, i cili kërkon vendimmarrjen e KQZ-së dhe atje do të aplikojnë shtetasit tanë që banojnë jashtë vendit, jo emigrantët. Këtej e tutje do t’i quajmë shtetas shqiptarë me banim jashtë vendit. Këta do të votojnë me kartën e identitetit që kanë në disponim apo me pasaportë. Pas kësaj krijohet regjistri i votuesve të shtetasve tanë me banim jashtë vendit dhe fillojnë procedurat përkatëse, sipas procedurave që do të përcaktojnë vendimmarrjet e KQZ-së.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti Majko!



Më lejoni që në përfundim të kësaj seance dëgjimore me Ministrin e Shtetit për Diasporën bashkë dhe me drejtoreshat përkatëse të drejtorive, pjesë e strukturës së kësaj ministrie, t’i falënderoj ata për këtë raportim të detajuar dhe mendoj me shumë interes për të gjithë publikun që na ndjek.

Në radhë të parë, më lejoni që në emër të këtij nënkomisioni t’i shpreh konsideratat më të larta zotit Majko, i cili në vijimësi për të gjithë këtë periudhë 4-vjeçare, që nga krijimi i Ministrisë së Shtetit për Diasporën me strukturën e qeverisë në vitin 2017 dhe në vazhdim i është përgjigjur vazhdimisht interesimit dhe interesit të treguar si nga ana e nënkomisionit përkatës, ashtu edhe nga Komisioni për Politikën e Jashtme, ka qenë prezent përherë dhe ka qenë i jashtëzakonshëm qëndrimi dhe mbështetja e tij për punën e nënkomisionit apo edhe të Komisionit për Politikën e Jashtme.

Në pikëpamjen time personale, por besoj se është edhe mendimi juaj, të nderuar kolegë, është model për të gjithë anëtarët e kabinetit qeveritar, me gjithë respektin për pjesën tjetër të tij.

Besoj se ka qenë një raportim i detajuar që, me gjithë organizimin e mbledhjes *online*, nuk na pengoi për ta elaboruar në detaje të gjithë këtë raportim. Jam i bindur që, edhe me buxhetin e ri që kaluam para pak ditëve për këtë ministri dhe për drejtoritë përkatëse, do të realizohen të gjitha synimet dhe objektivat e paraqitura nga kjo ministri.

Nuk më mbetet gjë tjetër, veçse t’i falënderoj të gjithë bashkë. Nga ana tjetër, shpreh besimin e plotë që të gjithë objektivat dhe synimet e kësaj ministrie do të realizohen me sukses për vitin në vazhdim.

Faleminderit të gjithëve! Ditë të mbarë!

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

## **MBYLLET MBLEDHJA**